

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,** me gjyqtarin individual Ilir Bytyqi dhe sekretaren juridike Gentiana Jashari, në çështjen penale kundër të pandehurës Q.P. nga Ferizaj, për shkak të veprës penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1199-4/15 të dt. 25.10.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Ismet Rrahmani dhe të pandehurës Q.P., me datë 14 Dhjetor 2016 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 19 Dhjetor 2016, përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

E pandehura: Q.P. e lindur me data e lindjes..... ne ....., nga i ati S., nëna Z. e gjinisë G., e gjendjes se mesme ekonomike, me vendbanim në Rr ” .....” nr. .. ne Ferizaj, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Se me datë 17.07.2015, rreth orës 08:10, në Fsh. Bibaj afër Kafiteris “.....” e pandehura duke drejtuar automjetin e markës “Renault Clio” me ngjyre te kaltër me targe te regjistrimit ....., në kundërshtim me dispozitat e nen 42.1 të LSKRR nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, në atë mënyrë që nuk u ka dhënë përparësi kalimi automjeteve ne rrugë dhe atë duke dashur të kyqet ne rrugën e Fsh. Bibaj vije automjeti i markës “Golf 4” me ngjyre te kaltër me targa te regjistrimit ..... te cilën e drejtonte i dëmtuari K.M. i cili ne pamundësi për tu ndalur godet automjetin e tipit Renault Clio ku pos dëmeve materiale lëndim te lehta trupor pëson siç janë të përshkruar në ekspertizën e dt. 02.10.2016.

**me të cilën kreu veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPK-së.**

**Andaj, Gjykata në bazë të nenit të sipërcituar dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 51, 73, 74 dhe 75 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së, e**

### **G J Y K O N**

- **ME DENIM ME GJOBE NË LARTESI PREJ 200 /dyqindë/ euro, të cilën gjobë është e obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi e merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.**
- **Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-ës, i njëjti do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 €, do të vuaj një ditë burgimi.**
- **I dëmtuarin K.M. nga Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet ne kontest civil.**
- **Obligohet e pandehura që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzetë/ €, si dhe shpenzimet e procedurës penale (ekspertizat mjeko ligjore dhe ekspertiza e komunikacionit) shumen prej 60.88 /gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetetë cent/ € në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.**

### **A r s y e t i m i**

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet

përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar te pandehurin gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën të evidentuar PP/II.nr.1199-4/15 e dt. 25.10.2016, ka ngarkuar të pandehurën Q.P., për veprën penale te rrezikim te trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 14.12.2016, në të cilën shqyrtim fillestar: *e akuzuara është deklaruar fajtores për veprën për të cilën e ngarkon akuza, si dhe më vjen keq për këtë aksident te komunikacionit, kërkoj falje publike dhe premtoj qe ne te ardhmen nuk do të përsëritet e njeta dhe kërkoj nga gjykata të më shqiptoj një dënim sa më të butë.*

Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtorë dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që e akuzuara ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPP-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit gjatë procedurës hetimore dhe në shqyrtimin fillestar: ekspertiza e komunikacionit e datës: 12.09.2016, ekspertiza mjeko ligjore e datës: 02.10.2016, raporti i aksidentit 2015-CFT-271 e datës. 17.07.2015, deklarata e te pandehures Q.P. dt, 17.07.2015, deklarata e të dëmtuarit K.M. dt. 17.07.2015, si dhe fotografit qe gjenden ne shkresat e lendes.
- të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cili është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarës ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale të rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi e pandehura nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, në atë mënyrë që nuk u ka dhënë përparësi kalimi automjeteve ne rrugë dhe atë duke dashur te kryqet ne rrugën e Fshatit Bibaj K. Ferizaj, ashtu që vije automjeti i markës “Golf 4” me ngjyre te kaltër me targa te regjistrimit ..... te cilën e drejtonte i dëmtuari K.M. i cili ne pamundësi për tu ndalur godet automjetin e tipit “Renault Clio” ku pos dëmeve materiale lëndim te lehte trupor merr i dëmtuari të përshkruar si ne ekspertizën e dt. 02.10.2016.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarën, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73,74 dhe 75 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se në të gjitha fazat e procedurës penale ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer e që këto rrethana i ndërliidhi me faktin se e pandehuri deri tani nuk ka qenë e dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuares si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga

kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, obligohet e akuzuara që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20/njëzetë/€ , si dhe shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjeko ligjore dhe ekspertiza e komunikacionit) shumen prej 60.88 /gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetë cent/ €, në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë, bazuar në komplikueshmërinë e kësaj çështje dhe gjendjen ekonomike të të pandehurës.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,**  
**P.nr.1038/16, dt.19.12.2016.**

**Sekretare Juridike,**  
**Gentiana Jashari**

**Gjyqtari Individual,**  
**Ilir BYTYQI**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.